



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**

Nr Prot 129/2014  
Data 27/10/2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 4.1 dhe 7 paragrafi 1.6 të Rregullores nr 02/2011, planit të veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" dhe pikës 3 të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr 09/168 të datës 29.01.2014 Zëvendës-Kryeministrja e Kosovës, nxjerr këtë :

**V E N D I M**

1. Themelohet Sekretariati Ndërinstitucional për Koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 .
- 2.
3. Sekretariatit Ndërinstitucional për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 ka këtë përbërje :
  - a) Zyra e Kryeministrit-Agjencia për Barazi Gjinore- Kryesuese e Sekretariatit
  - b) Ministria e Drejtësisë.
  - c) Ministria e Punëve të Jashtme
  - d) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
  - e) Ministria e Punëve të Brendshme.
  - f) Ministria e Forcës së Sigurisë.
  - g) Ministria e Pushtetit Lokal .
  - h) Ministria e Shëndetësisë.
  - i) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
  - j) Ministria e Financave.

Në cilësinë e ekspertëve dhe me të drejta të barabarta me anëtarët tjerë janë:

- a) Instituti i Kosoves për Administratë Publike.
  - b) Policia e Kosovës.
  - c) Instituti Gjyqësor i Kosovës.
  - d) Prokuroria e Shtetit.
  - dh) Përfaqësuese e OJQ-ve që punojnë në fushën e barazisë gjinore.
4. Kryesuesi/ja e Sekretariatit emëron Grupin Teknik për Planin e Veprimit i cili do ta mbështes Sekretariatit në realizimin e aktiviteteve.
  5. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit.

Zëvendëskryeministre e Republikës së Kosovës

**Vendimi i dërgohet:**

- Të gjithë anëtarve ;
- Agjencisë për Barazi gjinore
- Arkivit të Qeverisë.

**Edita Tahiri**